



A je ti ose dikush që ti e njeh që është bërë objekt i krimit?

Tek Kujdestaria e të pësuarve nga krimi (sued. Brottsofferjouren) merr mbështetje dhe informacion. Ne të dëgjojmë, të japim këshilla dhe rrëfejmë rreth procesit gjyqësor dhe çfarë të drejtash ke ti.

Kujdestaria e të pësuarve nga krimi, është një organizatë jofitimprurëse, e cila ju jep mbështetje viktimave që kanë pësuar nga krimi, dëshmitarëve dhe farefisit. Ndihma jonë nuk kushton gjë. Ti merr mbështetje, pavarësisht se nga cili krim ke pësuar dhe nuk ke nevojë të kesh bërë një lajmërim në polici. Atë çfarë na thua neve, nuk i tregojmë dikujt tjetër.

Kujdestaria e të pësuarve nga krimi, nuk është një organ zyrtar dhe organizata jonë është e pavarur nga aspekti politik ose aspekti fetar. Me qindra idealistë, njerëzit tanë të arsimuar, mbështesim çdo viktimë që ka pësuar nga krimi, dëshmitarët dhe farefisin, të cilët na drejtohen ne. Të drejtat e njeriut janë bazë e punës tonë.

Kujdestaria e të pësuarve nga krimi, përbëhet nga kujdestaritë lokale e të pësuarve nga krimi, anë e kënd vendit, dhe një kancelari e lidhjes si dhe një linjë kombëtare e telefonisë e cila është falas t' i telefonosh. Në linjën telefonike të Kujdestarisë e të pësuarve nga krimi, mundesh ti që e flet suedishten ose anglishten, të telefonosh e të bësh pyetje, të marrësh informacion ose të biesh në kontakt me një person në kujdestarinë tënde lokale e të pësuarve nga krimi, që mund të ndihmojë ty më tutje.

Kujdestaria e të pësuarve nga krimi të ofron mbështetje në shumë gjuhë të ndryshme. Vizito www.brottsofferjouren.se/spes për të parë nëse ne mund të japim mbështetje në gjuhën tënde. Ti, po ashtu, mund t' i telefonosh linjës tonë kombëtare të telefonisë në **116 006** për kontakt në suedisht ose në anglisht.

Mbështetja e cila ta kthen forcën

Kujdestaria e të pësuarve nga krimi ofron:

- Mbështetje njerëzore nga dikush që të dëgjon e të kupton
- Informacion për lajmërim në polici, procesin gjyqësor dhe për çështje të kompensimit
- Mbështetje në rast të një gjykimi eventual
- Ndihmë me kontakte me organet zyrtare dhe me shoqëritë e sigurimit

Mbështetja jonë është falas dhe ti mund të marrësh mbështetje në shumë gjuhë të ndryshme. Ti nuk ke nevojë të kesh bërë një lajmërim në polici.

Lexo më shumë në uebfaqen tonë:

www.brottsofferjouren.se/spes

BROTTSOFFER
JOUREN
☎ 116 006